VENDIM
Nr. 9, datë 13.1.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "LINJA 110 kV ME DY QARQE N/STACIONI BUSHAT – N/STACIONI VELIPOJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Linja 110 kV me dy qarqe n/stacioni Bushat – n/stacioni Velipojë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 323 460 (treqind e njëzet e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 323 460 (treqind e njëzet e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në zyrat e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të OSHEE sh.a.
9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të OSHEE sh.a.
10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Drejtoria Vendore Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT "NDËRTIMI I LINJËS 110 kV, nst. Bushat – nst. Velipojë"

Qarku: Shkodër

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: "tokë arë"

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhënat për pronësinë							Sip. shpronësimi për banesë m^2	Sip. shpronësimi për shtyllë m^2	Vlera e shpronësimit në lek/m^2	Vlera e shpronësimit në lekë për banesë	Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia sip. pronës m^2						
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Fshati Meglushe														
9		Angjelin Kole Velaj	2644			298/2	Arë	639		63	270		17,010.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14		Tonin Velaj	2644			58/2	Arë	1300		54	270		14,580.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Fshati Ranxe														
15		Frrok Dede Vila	3205			161/1	Arë	4500		84	270		22,680.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16		Ndoc Dod Buzukja	3205			162/7	Arë	4011		39	270		10,530.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17		Vinçenc Injac Çuni	3205			174/18	Arë	2180		60	270		16,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18		Martin Rrok Rrotani	3205			193/1	Arë	2550		102	270		27,540.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19		Ndoc Balto Rrotani	3205			196/1	Arë	1040		23	270		6,210.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19		Engjell Balto Rrotani	3205			196/2	Arë	1040		23	270		6,210.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20		Francesk Dode Rrotani	3205			198/1	Arë	3817		39	270		10,530.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23		Palok Mati Rrotani	3205			203/1	Arë	2300		26	270		7,020.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
24		Tonin Ndreka	3205			219/1	Arë	4070		39	270		10,530.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25		Leke Zef Rrotani	3205			218/1	Arë	3744		39	270		10,530.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Fshat i Ri														
28		Zef Mirash Hila	1648			58/1	Arë	14400		63	270		17,010.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30		Gjeto Tom Qarraj	1648			80/1	Arë	5620		54	270		14,580.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31		Lazer Pal Vuksani	1648			92/1	Arë	2059		63	270		17,010.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32		Aleksander Pjeter Muca	1648			105/1	Arë	12400		46	270		12,420.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Bushat														
1		Shaban Din Mustafa	1329			15/16	Arë	4440		84	270		22,680.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2		Zyhdi Riza Mustafa	1329			15/14	Arë	6047		64	270		17,280.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3		Gjon Hilaj	1329			17/13	Arë	15040		39	270		10,530.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4		Gezim Pervizi	1329			17/14	Arë	3918		64	270		17,280.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Fshati Gomsiqe e Re														
47		Tom Kol Nikolli	1799			772/3	Arë	1175		36	270		9,720.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

47	Martin Kol Nikolli		1799			772/2	Arë	2350		10	270		2,700.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Fshati Pulaj - Plazh														
56	Pjetër Kolë Preka		3072			1097/117	Arë	3676.6		84	270		22,680.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Total shpronësimi										**1198**			**323,460.00**	